



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 108/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Furnizim i Shërbimit të Lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me nr. REF-47595-01-16-2020, me fond limit 104,112,722.34 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Videl” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Teodor Keko”, Pallati Pelivani, Unaza e Re, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Spitali Rajonal Durrës
Adresa: Lagjia nr. 8, Rr. “Aleksandër Goga”, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.01.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Furnizim i Shërbimit të Lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me nr. REF-47595-01-16-2020, me fond limit 104,112,722.34 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 23.01.2020, operatori ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...]1. Në lidhje me fondin limit

Sipas Njoftimit të Kontratës, sasia e parashikuar për larje gjate periudhes 30 mujore eshte 500.566 kg, që është pak a shumë e njëjta sasi e kontraktuar nga SRD nga Tetori 2017 për një periudhë 30 mujore me cmim/njësi rreth 300 lekë/kg. Referuar Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës, rezulton se shërbimi që kërkohet të mbulohet nëpërmjet kësaj kontrate, përfshin Grumbullim, larje, tharje, hekurosje, dezinfektim, paketim, shpërndarje të materialit të butë, dhe ndërrimin/shtrimin e shtratit të pacientit. Përveç elementëve të listuar më sipër, nga AK është kërkuar edhe që operatori ekonomik kontraktues duhet të furnizojë edhe bazën

materiale të inventarit të butë në fillim të kontratës, në vijim sipas grafikut të amortizimit dhe në përmbyllje të saj, për të gjitha shërbimet spitalore duke përfshirë: material të butë për pacientët dhe shtretërit (përfshirë edhe dyshekë), për sallat e opertacionit dhe për personelin mjekësor. AK ka përllogaritur furnizimin me material të butë për një total prej 486 shtretërisht me koeficient të mbulimit të plotë me shërbim (përfshirë furnizimin e materialit të butë) për 287 prej tyre, nga të cilët minimalisht 70 shtretër duhet të kompletohen të reja që në fillim të zbatimit të kontratës. Nisur nga informacioni i mësipërm në lidhje me Specifikimet Teknike dhe Termat e Referencës, si dhe nga informacioni që disponojmë mbi kostot e këtij shërbimi, si një operator me sukses në rritje, duket qartë se AK Spitali Rajonal Durrës, nuk ka zbatuar rregullat për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës sipas parashikimeve të rregullave të prokurimit në fuqi. Për këtë arsye, fondi i vënë në dispozicion të kësaj kontrate është tërësisht i pamjaftueshëm për realizimin e saj dhe rrezikon që ose ta shpjerë procedurën në dështim ose të cojë në zbatimin e kontratës nga operatorë jo seriozë dhe të papërgjegjshëm që do të çënojnë sasinë dhe cilësinë e shërbimit për SRD. Më konkretisht, në bazë të vlerës limit të kontratës së shpallur dhe sasisë së parashikuar për Shërbim, rezulton se cmimi limit për njësi i përllogaritur nga AK është ~208 lekë/kg. VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në nenin 59, ka përcaktuar që: 1. Përllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme. 2. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose dhe c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet. Na rezulton se për përllogaritjen e vlerës limit, nuk është zbatuar dispozita e mësipërme, pasi asnjë nga alternativat e përcaktuara në pikën 2 nuk duket të jetë përdorur nga AK. INSTATI dhe institucione të tjera shtetërore, si dhe as çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht nuk japin informacion mbi çmime zyrtare për shërbimin në fjalë, sepse ky është një shërbim i përbërë nga disa elementë (shërbime të përbëra që përfshijnë edhe furnizim mallrash). Gjithashtu nuk është aplikuar as metoda e studimit të tregut, pasi nuk na rezulton, që as ne as operatorë të tjerë nuk janë ftuar të kuotojnë për këtë qëllim nga SRD. Më konkretisht, aktualisht spitalet publike e kanë kontraktuar këtë shërbim për periudha 24-48 muaj, dhe në periudhën 2016-2019, nga të dhënat publike mbi këto kontrata (për një pjesë të të cilave edhe ne kemi konkuruar), rezultojnë që ky shërbim kontraktohet në 3 (tre) kategori: GRUPI A: Spitalet që kontraktojnë shërbimin duke përfshirë në të vetëm mbledhje, larje, tharje, hekurosje, dezinfektim dhe shpërndarje e shtrim të materialit të butë. GRUPI B: Spitalet që kontraktojnë shërbimin duke përfshirë në të mbledhje, larje, tharje, hekurosje, dezinfektim dhe shpërndarje e shtrim të materialit të butë + furnizim të materialit të butë për një volum prej deri në 200 shtretër. GRUPI C: Spitalet që kontraktojnë shërbimin duke përfshirë në të mbledhje, larje, tharje, hekurosje, dezinfektim dhe shpërndarje e shtrim të materialit të butë + furnizim të materialit të butë për një volum mbi 200 shtretër. Çmimet e kontratave të lidhura apo të shpallura për prokurim për këto grupe janë si vijon:

GRUPI A		GRUPI B		GRUPI C	
Autoriteti Kontraktor	Cmimi leke/kg	Autoriteti Kontraktor	Cmimi leke/kg	Autoriteti Kontraktor	Cmimi leke/kg
Spitali Berat	129	Spitali Psikiatrik Ali Mihali Vlore	241	SUOGJ Mbreteresha Geraldine	295
Spitali Lezhë	100	Spitali Psikiatrik Sadik Dinci Elbasan	277	QSUT	358
		Spitali Xh.Kongoli Elbasan	395	Spitali Rajonal Vlore	300
		Spitali Korçe	207	Spitali Universitar i Traumes	300
		Spitali Sarandë	348	SUOGJ Koco Glozheni	376
				Spitali Rajonal Durrës	307
Cmimi mesatar	115	Cmimi mesatar	293	Cmimi mesatar	328

Nga analiza e mësipërme e kontratave të mëparshme në sektorin publik për këtë shërbim, rezulton qartë se cmimi mesatar i grupit të cilit i përket Spitali Rajonal Durrës (GRUPI C), është rreth 330 lekë/kg, pra edhe më i lartë se cmimi për njësi i kontratës aktuale në Spitalin Rajonal Durrës. AK duket se i është referuar ekzaktesisht cmimit më të ulët të spitaleve të grupit të dytë, por kjo referencë është tërësisht e gabuar dhe jo në përputhje me rregullat e prokurimit sepse: (i) si rregull nuk mund të bëhet referencë në cmimin më të ulët, por në një mesatare të cmimeve të kontratave të mëparshme; dhe (ii) SRD për nga volumi i shërbimit që kërkon të marrë, i përket grupit të tretë dhe jo grupit të dytë, pasi sasia e shtretërve që kërkon t'u shërbehet është ndjeshëm më e lartë se 200 dhe gjithashtu edhe investimi i kërkuar me material të butë, vecanërisht për këtë kontratë, është shumë më i lartë se niveli i investimit furnizim me material të butë që është bërë në kontratat për spitalet e Grupit III. Ne jemi të vetëdijshëm që synimi i autoriteteve kontraktore është kursimi sa më shumë të jetë e mundur i fondeve publike, por në rastin konkret nuk bëhet fjalë për kursim por për pamjaftueshmëri thelbësore të fondit të përlllogaritur, cka rrezikon seriozisht si pjesëmarrjen dhe konkurrencën gjatë procedurës ashtu edhe realizimin dhe zbatimin e kontratës sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike. Pasoja direkte e kësaj do të ishte mungesa dhe dështim në dhënien e shërbimit ose në cilësinë dhe standartet e nevojshme për këtë shërbim jetësor të strukturës spitalore. Një fond i përlllogaritur kaq në pamjaftueshmëri do të mbante larg operatorët seriozë, të kualifikuar dhe me eksperiencë dhe rrezikon të joshë operatorë ekonomikë aventurierë dhe të pakualifikuar mjaftueshëm, që vetëm për të fituar kontratën mund të premtojnë realizimin e saj pa qenë realisht në gjendje për dicka të tillë. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që të rishikohet fondi limit i përlllogaritur duke bërë studimin e detajuar të elementeve të kostos për këtë shërbim dhe aplikimin e alternativave "a) cmimet e tregut ose dhe b) cmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjere kontraktore'" të parashikuara në nenin 59 pika 2 të VKM datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndrvshuar.

2. Në lidhje me kriterin 3.3.6 të Shtojcës 8.

Në këtë kriter nga AK është kërkuar: "License per nderrimin/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL." Kjo kërkesë është evazive dhe e papërcaktuar qartë se çfarë lloj licence kërkohet, me çfarë kodi dhe çfarë natyre. Sqarojmë me këtë rast se aktiviteti objekt i kontratës nuk kërkon ndonjë licencë të caktuar/specifike të lëshuar nga QKL. VKM nr 914 datë 29.12.2014 ne nenin 28, pika 2, percakton qe "Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve" Sqarojmë se sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licensat në RSH dhe ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, Shtojca 1 "Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi, konkretisht përcaktuar në pikën "Veprimtarite e tjera qe perdorin solvente ID 7.12/l. Pastrimi kimik", rezulton se në lidhje me aktivitetin në fjalë, QKB lëshon vetëm Leje Mjedisore e tipit "C" për aktivitetin Pastrim Kimik me Kod III.1.A. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që të hiqet kjo pikë nga Dokumentat e Tenderit ose AK të përcaktojë në mënyrë specifike llojin kodin dhe emërtimin e licensës që kërkon.

3. Në lidhje me kriteret 3.3.12 të Shtojcës 8

Në këtë kriter nga AK ndër të tjera është kërkuar: "Ne lidhje me numrin e punonjesve ne lavanderi te kerkuar, gjithesej 10, eshte numri minimal i parashikuar per te mbuluar sherbimin ne nje lavanderi profesionale me kapacitet larës, dezifektues, thares, hekuroses dhe paketues sipas ker kesave te SRD. Ne kete numer nuk eshte perfshire stafi drejtues. Ne rast se ndonje nga operatoret ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavdinderise.

Kriteret për kualifikim i shërbejnë AK për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë pajisjet e asetet e tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në LPP është në të drejtë të AK të përcaktojë kriteret për kualifikim, të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në LPP, por gjithmonë duke i përcaktuar qartë këto kritere në nivelin minimal të kërkuar, në funksion të qëllimit të parimeve të ligjit për prokurimin publik. VKM nr.914, datë 29.12.2014, ne nenin 28, pika 2, percakton qe "Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve." Sic kërkohet në frymën e LPP dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014, AK duhet të përcaktojë në Dokumentat e Tenderit minimumin e kritereve për kualifikim, duke i dhënë këto të qarta dhe jo evazive, që të mos krijojnë pasiguri, paqartësi konfuzion dhe lexime të ndryshme nga OE të ndryshëm konkurues. Gjithashtu, kritere të formuluar në mënyrë të paqartë dhe konfuze, mund të krijojnë situata pabarazie në qasjen ndaj dhe trajtimin e diferencuar të OE ofertues duke shkelur kështu parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Pikërisht një situatë të tillë krijon fjalina e fundit e cituar më sipër dhe e theksuar me "bold", pasi krijon premisa që OE të cilët nuk plotësojnë dot numrin minimal prej 10 punonjësish në lavanderi ta kapërcejnë këtë mospënbushje me vlerësime subjektive të KVO, për sa kohë nuk ka parametra sasiorë të cilësuar qartë për kushtet dhe rrethanat që mund të lejojnë KVO të pranojë shmangien nga plotësimi i këtij kriteri. Gjithashtu parashikimi i një përjashtimi të tillë në mënyrë të tillë evazive dhe të paqartë, krijon hapësira për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, pasi në një kohë që OE të ndryshëm janë

të investuar me një numër të konsiderueshëm punonjësish dhe llogarisin të tilla kosto realisht në ofertat e tyre, KVO i krijohen hapësira që të ngjisë në renditje OE të tjerë që nuk e kanë të plotësuar numrin minimal të punonjësve, pra edhe kanë më pak kosto për të përlllogaritur në vlerën e ofertës së tyre. Në këtë mënyrë rrezikohet të cënohen rëndë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe në rastin më të keq, kjo mund të jetë e vendosur në mënyrë të qëllimshme që në kombinim me uljen artificiale të fondit limit, të lejojë dhe të favorizojë hyrjen në garë dhe kualifikimin e OE që s'kanë kapacitete dhe shërbime të ngjashme në nivelin e nevojshëm për zbatimin e një kontrate të tillë. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që tek kriteri 3.3.12 në pjesën e sipërcituar të hiqet fare fjalia "Ne rast se ndonje nga operatorët ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise [...]"

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimes "Videl" sh.p.k., me anë të shkresës nr.196/3prot., datë 27.01.2020, duke e pranuar pjesërisht atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"[...]Ne lidhje me perlllogaritjen e fondit limit, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi pa edhe dokumentacionin e vene ne dispozicion nga ana e Komisionit te Posacem per percaktimin e specifikimeve teknike, fondit limit dhe termave te references, me Nr. 1692/1 prot, date 22.10.2019, konstatoi se per caktimin e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, komisioni i posacem eshte bazuar ne percaktimet e bera ne nenin 59 te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, konkretisht germa b) çmimet e kontratave te meparshme, te realizuara nga vete apo nga autoritete te tjera kontraktore duke marr cmimin me te ulet prej tyre. Ne keto kushte arsyetimi juaj mbi ndarjen dhe klasifikimin e Spitalëve dhe detyrimi per te marr cmimin mesatar nuk gjen baze ligjore ne asnje dispozite te legjislacionit qofte te atij per prokurimin publik, qofte te atij per rregullimin e sherbimeve spitalore. Vleresojme se veprimet e kryera nga Komisioni Posacem per percaktimin e fondit limit jane kryer ne rrespektim te plote te percaktimeve sipas VKM Nr. 914 date 29.12.2014, i ndryshuar neni 59.Per sa me siper ankesa juaj nuk qendron.

Persa i perket ankeses se OE ne lidhje me licensen per nderrim/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL vlereson ta ndryshoje si me poshte:

Ishte:

"6. License per underrimin/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL."

Behet:

"6. License per ushtrimin e aktivitetit Lavanderi, leshuar nga QKL"

Përsa paraqitur mësipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes "Videl" sh.p.k. qëndron.

Komisioni vlereson se kerkesa e AK lidhur me numrin e punonjesve te sherbimit te kerkuar per mbulimin e sherbimit ne te gjitha pavionet e SRD-se eshte ne perputhje te plote me natyren dhe vleren e kontrates se prokuruar. Gjithashtu sqarimi se "Ne rast se ndonje nga operatorët ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise, nuk eshte nje kriter diskriminues dhe i vendosur me qellim per te kompromentuar

procesin e vleresimit, apo per te bere nje trajtim te pabarabarte te operatoreve ekonomik, dhe eshte vendosur ne perputhje me parashikimet e LPP neni 46 ku kerkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit. Per nje vleresim sa me objektiv, ne menyre qe me vendosjen e ketij paragrafi dhe paraqitjes se planit te punes per organizimin e brendshem te lavanderise, se bashku me numrin e pajisjeve dhe grafikun e oreve te punes per secilin punonjes, i jep mundesine cdo operatori ekonomik, biznes i madh, i mesem apo i vogel qe i permbush keto kriteret te jete pjesmarres ne kete procedure prokurimi. Ndersa me argumentimin e dhene nga ana juaj se vendosja e ketij kriteri do te bente te mundur pjesmarrjen ne kete procedure edhe te operatoreve ekonomik “pa kapacitetet e mjaftueshme”, ky eshte nje argument paragjykes dhe nxjerr ne pah se qellimi juaj per heqjen e ketij kriteri eshte vendosja e kufijve vetem per disa operatore te caktuar qe mund te kene mundesine e permbushjes se ketij kriteri. Per sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, vlereson se ankesa e OE Videll shpk ne lidhje me kete kriter, nuk qendron, por shikon te arsyeshme te perfshije ne te disa sqarime, duke e ndryshuar kete kriter perfundimisht si me poshte:

Ishte: sqarojme se: Ne lidhje me numrin e punonjesve ne lavanderi te kerkuar, gjithesej 10, eshte numri minimal i parashikuar per te mbuluar sherbimin ne nje lavanderi profesionale me kapacitet lares, dezinfektues, thares, hekuroses dhe paketues sipas kerkesave te SRD. Ne kete numer nuk eshte perfshire stafi drejtues. Ne rast se ndonje nga operoret ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise.

Behet: sqarojme se: Ne lidhje me numrin e punonjesve ne lavanderi te kerkuar, gjithesej 10, eshte numri minimal i parashikuar per te mbuluar sherbimin ne nje lavanderi profesionale me kapacitet lares, dezinfektues, thares, hekuroses dhe paketues sipas kerkesave te SRD. Ne kete numer nuk eshte perfshire stafi drejtues. Ne rast se ndonje nga operoret ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise, sic eshte plani i punes i funksionimit te brendshem te lavanterise, grafikun per oret e punes per secilin punonjes; [...]

II.4.Në datën 04.02.2020, operatori ekonomik ankimues “Videll” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke shtuar argumentat si më poshtë:

“[...]1.Në lidhje me kërkesën për fondin limit dhe mënyrën e përllogaritjes.

KSHA e AK, në mënyrë sipërfaqësore, jo vetëm nuk ka sjelle asnjë argument ligjor për refuzimin e ankesës sone, por thjesht ka referuar në nenin 59 (2) pika b të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e cila përcakton referimin në kontratat e mëparshme të ngjashme, por nuk përcakton që zgjidhet në mënyrë mekanike vlera më ulët prej këtyre kontratave, por që këto vlera përdoren si vlera referuese në përllogaritjen e fondit. Pra, ashtu sic ne kemi bërë një përllogaritje të thejshme duke marrë në konsideratë edhe elementët e kostos së këtij shërbimi edhe informacionin për kontratat të mëparshme publike, ashtu duhet të kishte vepruar edhe AK në kryerjen e kësaj detyre dhe jo të marrë në mënyrë mekanike vlerën më të ulët absolute të kontratave të shërbimit të lavanderisë. Për më tepër, KSHA, ka hedhur poshtë

edhe vlerat referuese të shërbimit në kontratën që vetë SRD ka në zbatim, cka është absurd dhe tërësisht jo profesionale.

2. Në lidhje me kërkesën për saktësimin e licensës së kërkuar në pikën 3.3.6 të Shtojcës 8. Nga një anë KSHA, shprehet së pretendimi jonë qëndron, por në ndryshimin e parashtruar nga KSHA, nuk është reflektuar një pranim i tillë, pasi sërish kriteri nuk ka përcaktuar në mënyrë specifike llojin, kodin dhe emërtimin e licensës së kërkuar. Ne kemi qenë të qartë se në lidhje me aktivitetin në fjalë, QKB lëshon vetëm Leje Mjedisore e tipit "C" për aktivitetin Pastrim Kimik me Kodi III.1.A., por KSHA nuk ka bërë një ndryshim të tillë që të tregojë se me të vërtetë kërkesa jonë për këtë është pranuar.

3. Në lidhje me evazivitetin në kriterin në pikën 3.3.12 të Shtojcës 12 për numrin e punëtorëve. KSHA sërish nuk sjell asnjë argument ligjor për mospranimin e ankesës sonë për këtë kriter. Ne kemi sqaruar se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të shprehura qartë dhe saktë në terma sasiorë minimalë dhe nuk mund të ketë kritere kualifikimi që lihen të hapura për tu vlerësuar nga KVO gjatë fazës së vlerësimit të ofertave. Ndryshe nga sa pretendon KSHA që kërkesa jonë synon të kufizojë garën duke mos lejuar numër më të ulët punëtorësh, kjo nuk është e vërtetë, pasi e vetmja gjë që ne kemi kërkuar, është që edhe nëse AK është i gatshëm të pranojë një numër më të ulët punëtorësh, le ta përcaktojë që në fillim këtë numër me ulje, por jo ta lerë në diskrecion të KVO, pasi le shteg për subjektivizma dhe garë të pabarabartë. i Gjithashtu, nëse AK do ti lërë KVO kompetenca të vlerësimit me fleksibilitet të këtij kriteri, ka të gjitha mundësitë që numrin e punëtorëve pasi të ketë përcaktuar një minimum si kriter kualifikimi, ta vendosë si kriter vlerësimi përkrah kriterit të cmimit [...]”

II.5.Në datë 20.02.2020, nëpërmjet shkresës me nr.374/1prot., datë 14.02.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. për pamjaftueshmërinë e fondit limit, si dhe procedurën e përlogaritjes së tij, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë

konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”

III.1.2. Në nenin 59, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

- çmimet e tregut;ose/dhe

- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

- çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

III.1.3. Nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton se është paraqitur dokumenti nr.1692/6prot., datë 27.12.2019, i mbajtur nga grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Në këtë dokument, pasqyrohet përlllogaritja e fondit limit, si më poshtë:

Tabela 8. Cmimet e referencës

Nr	Institucionet Spitalore	Cmimi pa tvsh	Cmimi me tvsh
1	QSUT	385,5	430,2
2	Spitali Psikiatrik Vlorë	245,79	294,94
3	Spitali Rajonal Durrës	300,00	360,00
4	Spitalsali Rajonal Korce	207,99	249,59

III.1.4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, Komisioni konstaton se, grupi i punës i ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke u bazuar në kontratat e mëparëshme të autoriteteve të tjera kontraktore, si dhe kontratën e tij të mëparëshme, të cilat janë me objekt të njëjtë me atë të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, e në vijim ka mbajtur proces-verbalin përkatës duke u bazuar në cmimin më të ulët për njësi “lekë/kg”, që i përket kontratës së shërbimit të Spitalit Rajonal Korce. KPP sqaron se, në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, hartimin dhe miratimin e buxhetit, mirëpërdorimin e fondeve dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe përgjegjës direkt për përlllogaritjen e fondit limit dhe argumentimin e tij. Komisioni gjykon se, fondi limit i procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, nuk është përlllogaritur në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës 2 të nenit 59, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor nuk ka kryer përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në

specifikimet teknike dhe termat e referencës të objektit që prokurohet, por e ka kryer atë duke marrë cmimin më të ulët të kontratës të mëparëshme të një autoriteti tjetër kontraktor, e cila ka të tjera sasi, si dhe të tjera specifikime teknike dhe terma reference. Komisioni thekson se, kontratat e mëparëshme të autoriteteve të tjera kontraktore mund të merren në konsideratë si referencë, por jo të përcaktohet cmimi konkret i njëjës prej tyre, pasi kjo do të binte ndesh me përcaktimin e pikës 2 të nenit 59, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: *“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”*. Vlen të theksohet se, fondi limit i përllogaritur, është 62,553,778 lekë pa tvsh më pak, se fondi limit i procedurës së mëparëshme të prokurimit të vetë autoritetit kontraktor, ku konstatohet se sasi të dhe specifikimet teknike nuk kanë diferencë kaq të madhe. Në këto kushte, Komisioni gjykon se përllogaritja e fondit limit, duke mos u bazuar në specifikimet teknike dhe termat e referencës të kontratës objekt prokurimi, si dhe aktualitetin e tregut, con drejtë pamjaftueshmërisë të fondit limit, e për rrjedhojë shkaktimin e rrezikut potencial, të paraqitjes të ofertave të papërgjegjshme. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të ripërllogarisë fondin limit të kontratës objekt prokurimi, duke u bazuar në specifikimet teknike dhe termat e referencës të objektit të saj të prokurimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: *“Në këtë kriter nga AK është kërkuar: “License per nderrimin/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL.” Kjo kërkesë është evazive dhe e papërcaktuar qartë se çfarë lloj licence kërkohet, me çfarë kodi dhe çfarë natyre. Sqarojmë me këtë rast se aktiviteti objekt i kontratës nuk kërkon ndonjë licencë të caktuar/specifike të lëshuar nga QKL. VKM nr 914 datë 29.12.2014 ne nenin 28, pika 2, përcakton që “Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve” Sqarojmë se sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licensat në RSH dhe ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi, konkretisht përcaktuar në pikën “Veprimtarite e tjera që perdorin solvente ID 7.12/l. Pastrimi kimik”, rezulton se në lidhje me aktivitetin në fjalë, QKB lëshon vetëm Leje Mjedisore e tipit “C” për aktivitetin Pastrim Kimik me Kod III.1.A. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që të hiqet kjo pikë nga Dokumentat e Tenderit ose AK të përcaktojë në mënyrë specifike llojin kodin dhe emërtimin e licensës që kërkon”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.6 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: *“6.License per nderrimin/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL.”*

III.2.2. Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

“ISHTE:

3.3 Kapaciteti teknik:

6. License per nderrimin/shtrimin e aktivitetit lavanderi, leshuar nga QKL.

BËHET:

6. License per ushtrimin e aktivitetit Lavanderi, leshuar nga QKL”

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.4. Nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë licencë për ushtrimin e veprimtarisë “Lavanderi”, të lëshuar nga QKL. Referuar, legjilacionit sektorial mbi licencat dhe lejet të cilat lëshohen nga QKL, Komisioni thekson se, për cdo veprimtari për të cilat është e detyrueshme pajisja me licencën përkatëse, përkon një kod i posacëm licencimi. Komisioni gjykon se pavarësisht se kriteri i mësipërm është modifikuar nga autoriteti kontraktor, përsëri mbetet konfuz dhe jo i plotë, pasi nuk është përcaktuar kodi konkretë i licencës që kërkohet. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, të cilat duhet të jenë gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit, të qarta, si dhe bazuar në legjilacionin në fuqi për prokurimin publik dhe atë sektorial. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kodin e licencës të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “Sic kërkohet në frymën e LPP dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014, AK duhet të përcaktojë në Dokumentat e Tenderit minimumin e kriterëve për kualifikim, duke i dhënë këto të qarta dhe jo evazive, që të mos krijojnë pasiguri, paqartësi konfuzion dhe lexime të ndryshme nga OE të ndryshëm konkurues. Gjithashtu, kriteret të formuluar në mënyrë të paqartë dhe konfuzë, mund të krijojnë situata pabarazie në qasjen ndaj dhe trajtimin e diferencuar të OE ofertues duke shkelur kështu parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Pikërisht një situatë të tillë krijon fjalitë e fundit e cituar më sipër dhe e theksuar me “bold”, pasi krijon premisa që OE të cilët nuk plotësojnë dot numrin minimal prej 10 punonjësish në lavanderi ta kapërcejnë këtë mospënbushje me vlerësime subjektive të KVO, për sa kohë nuk ka parametra sasiorë të cilësuar qartë për kushtet dhe rrethanat që mund të lejojnë KVO të pranojë shmangien nga

plotësimi i këtij kriteri. Gjithashtu parashikimi i një përjashtimi të tillë në mënyrë të tillë evazive dhe të paqartë, krijon hapësira për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, pasi në një kohë që OE të ndryshëm janë të investuar me një numër të konsiderueshëm punonjësish dhe llogarisin të tilla kosto realisht në ofertat e tyre, KVO i krijohen hapësira që të ngjisë në renditje OE të tjerë që nuk e kanë të plotësuar numrin minimal të punonjësve, pra edhe kanë më pak kosto për të përlllogaritur në vlerën e ofertës së tyre. Në këtë mënyrë rrezikohet të çënohen rëndë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe në rastin më të keq, kjo mund të jetë e vendosur në mënyrë të qëllimshme që në kombinim me uljen artificiale të fondit limit, të lejojë dhe të favorizojë hyrjen në garë dhe kualifikimin e OE që s'kanë kapacitete dhe shërbime të ngjashme në nivelin e nevojshëm për zbatimin e një kontrate të tillë. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që tek kriteri 3.3.12 në pjesën e sipërcituar të hiqet fare fjalia "Ne rast se ndonje nga operatorët ekonomik pretendon se këte shërbim mund ta mbulojë me një numër më të vogël punetoresh duhet të paraqesi informacion sqarues dhe provues shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.12 "Për kapacitetin teknik", të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:
1 "Kërkohet që ofertuesi të paraqese, deklarate që verteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate si më poshtë:

Tabela 1. Numri minimal i punonjësve për mbulimin e shërbimit

Nr	Personeli	Numri minimal i punonjësve për mbulimin e shërbimit
1	<i>Punetor ne lavanderi</i>	10
2	<i>Shofer</i>	2
3	<i>Punetor ngarkimi / shkarkimi</i>	1
4	<i>Pergjegjes shërbimi ne SRD</i>	2
5	<i>Punonjese shërbimi ne SRD</i>	27
	TOTALI	42

sqarojme se:

Ne lidhje me numrin e punonjësve ne lavanderi te kerkuar, gjithesej 10, eshte numri minimal i parashikuar per te mbuluar shërbimin ne nje lavanderi profesionale me kapacitet lares, dezifektues, thares, hekuroses dhe paketues sipas kerkesave te SRD. Ne këte numer nuk eshte perfshire stafi drejtues. Ne rast se ndonje nga operatorët ekonomik pretendon se këte shërbim mund ta mbulojë me një numër më të vogël punetoresh, duhet të paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise."

III.3.2. Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

“sqarojme se:

-Ne lidhje me numrin e punonjesve ne lavanderi te kerkuar, gjithesej 10, eshte numri minimal i parashikuar per te mbuluar sherbimin ne nje lavanderi profesionale me kapacitet lares, dezifektues, thares, hekuroses dhe paketues sipas kerkesave te SRD. Ne kete numer nuk eshte perfshire stafi drejtues. Ne rast se ndonje nga operatoret ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise, sic eshte plani i punes i funksionimit te brendshem te lavanterise, grafikun per oret e punes per secilin punonjes.”

III.3.3.Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.3.4.Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i kriterit objekt ankimi, Komisioni gjykon se përcaktimi lejues “Ne rast se ndonje nga operatoret ekonomik pretendon se kete sherbim mund ta mbuloj me nje numer me te vogel punetoresh, duhet te paraqesi informacion sqarues dhe provues, shtese ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e lavanderise, sic eshte plani i punes i funksionimit te brendshem te lavanterise, grafikun per oret e punes per secilin punonjes.”, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi për prokurimin public, pasi shkakton vlerësim subjektiv, trajtim të pabarabartë, si dhe konfuzin si te operatorët ekonomik, ashtu dhe te komisioni i vlerësimit të ofertave. Kriteret për kualifikim duhet të jenë sa më të qartë, si dhe duhet të përcaktohet dokumentacioni konkretë që duhet të paraqitet për përmbushjen e tyre. Në këto kushte, për të krijuar një garë transparente, objektive dhe të barabartë, autoriteti kontraktor duhet të heqë fjalinë e mësipërme nga kriteri i vecantë i kualifikimit, duke përcaktuar një kriter shterues lidhur me numrin minimal të punonjësve, të cilët gjykohen të domosdoshëm nga autoriteti kontraktor për zbatimin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k. qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Videl” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Furnizim i Shërbimit të Lavanterisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me nr. REF-47595-01-16-2020, me fond limit 104,112,722.34 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit.
3. Me rishpalljen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Videl” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 141 Protokoli, Datë 04.02.2020;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha